

Komuna e Parteshit: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Parteshit përbëhet nga tri zona kadastrale dhe banohet me popullsi me shumicë serbe. Kjo komunë, që më parë ishte pjesë e territorit të Komunës së Gjilanit, ka një sipërfaqe prej 28,6 km² dhe me popullsi sipas shifrave komunale prej 5.100 banorësh. Por, ky numër i banorëve nuk është ai i dalë nga regjistrimi i popullsisë më 2011. Shifrat nga regjistrimi i popullsisë tregojnë se Komuna e Parteshit ka 1.787 banorë. Kjo për shkak të bojkotimit të procesit të regjistrimit nga ana e serbëve lokal.
2. Kryetari i Komunës së Parteshit është Nenad Svetković nga partia “Zavicaj”, e cila ka gjashtë ulëse në Kuvendin Komunal. Nga tre ulëse kanë edhe Lista e Bashkuar Serbe dhe Iniciativa Qytetare Serbe. Dy vende i ka Partia e Serbëve të Kosovës dhe me një vend është e përfaqësuar edhe Partia Demokratike Serbe. Gjithsej, Kuvendi Komunal i Parteshit ka 15 ulëse.
3. Komuna e Parteshit është formuar pas decentralizimit, sipas Pakos së Ahtisaarit më 19 gusht 2010, pas zgjedhjeve lokale të cilat janë mbajtur më 18 qershor 2010. E themeluar si Komuna e Parteshit, në statut të komunës figuron si Komuna Partesh/Pasjan. Të gjitha dokumentet dhe njoftimet zyrtare lëshohen me këtë emërtim.¹
4. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Komunën e Parteshit është 86, prej tyre 46 të punësuar në administratë, 32 në arsim dhe 8 në shëndetësi. Komuna ka themeluar gjashtë drejtori komunale.²
5. Ne bazë të një hulumtimi të Demi/USAID, vetëm 49% e qytetarëve në Komunën e Parteshit janë të kënaqur me punën e Kryetarit të Komunës. Ndërsa shifra rezulton edhe më e vogël për kënaqshmërinë e banorëve të Parteshit me administratën komunale që sipas këtij hulumtimi vetëm 38% e qytetarëve janë të kënaqur.³

¹ Komuna e Parteshit. Faqja zyrtare. Takimet e Kryetarit. 2013. Burimi: <http://kk.rks.gov.net/partesh/News/OBELEZENA--TRECA--GODISNJICA--RADA-OPSTINE-PARTES.aspx>

² Komuna e Parteshit. Raporti Financiar janar – dhjetor 2011. Fq 14.

³ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 114. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Albanian_216825.pdf

Problemet kryesore të Komunës së Parteshit

- 1. Mungesa e shkollës fillore në fshatin Budrigë e Poshtme.** Në këtë fshat nuk ekziston një shkollë fillore dhe banorët detyrohen t'i dërgojnë fëmijët në shkollën më të afërt në Pasjan e cila ndodhet rreth 5 km larg. Banorët e këtij fshati i'u kanë drejtuar disa herë komunës me qëllim që ky problem të zgjidhet, madje disa nga banorët kanë shprehur gatishmërinë që të japin pa kompensim pronën e tyre me qëllim të ndërtimit të shkollës. Aktualisht, nuk ka ndonjë plan komunal për ndërtimin e kësaj shkolle. Sipas hulumtimit të UNDP-së të përmbledhura në raportin "Mozaiku i Kosovës" thuhet se banorët e Parteshit janë më pak të kënaqur si me qasjen ashtu edhe me cilësinë e arsimit në të gjitha nivelet e shkollimit, në krahasim me mesataren e Kosovës. Dallimet më të mëdha janë regjistruar në numrin e atyre që janë të kënaqur me cilësinë e arsimit në shkollat fillore (54% në krahasim me mesataren e Kosovës që është 75%), cilësinë e arsimit në institucionet parashkollore (53% në krahasim me mesataren e Kosovës 69%), qasjen në arsimin fillor (66% në krahasim me mesataren e Kosovës 78%), dhe cilësinë e arsimit në shkollat e mesme (55% në krahasim me mesataren e Kosovës 66%).⁴
- 2. Mos inspektimi i ndërtimeve.** Komuna e Parteshit nuk ka arritur akoma të vë në funksion inspektoratin e urbanizmit. Kjo komunë nuk kryen asnjë kontrollë ndaj ndërtimeve dhe nuk lëshon leje të ndërtimit. Shtëpitë ndërtohen edhe në arat bujqësore. Andaj, qytetarët e konsiderojnë këtë dukuri si të dëmshme për komunën në përgjithësi. Vetëm 19% e qytetarëve në Komunën e Parteshit janë të kënaqur me planifikimin urban të qytetit, përkatësisht 81% deklarohen të pakënaqur me planifikimin urban të hapësirave në komunën e tyre, përderisa përqindja është edhe me e ulët kur pyeten për kontrollin e ndërtimeve 17%, konkretisht 83% e banorëve të Parteshit janë deklaruar të pakënaqur me kontrollimin e ndërtimeve në Komunën e tyre.⁵
- 3. Menaxhimi i çerdhes nga ana e Kishës Ortodokse.** Parteshi ka një çerdhe. Ajo është në oborrin e kishës dhe menaxhohet nga ana e kishës. Ky problem nuk ka arritur të zgjidhet nga ana e komunës. Komuna nuk ka asnjë plan për ndërtimin e çerdhes në

⁴ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. "Mozaiku i Kosoves". 2012. Fq 113. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216825.pdf

⁵ Qendra Regionale për Mjedis. Komuna e Parteshit. Raporti i të gjeturave nga Hulumtimit mbi Planin e veprimt lokal ne Mjedis. Fq 169.

ndonjë lokacion tjetër dhe transferimin e stafit nga çerdhja që është në oborr të kishës në ndonjë çerdhe tjetër. Banorët jo serbë nuk mund t'i dërgojnë fëmijët në çerdhen ekzistuese. Sipas hulumtimit të UNDP-së ("Mozaiku i Kosovës"), thuhet se banorët e Parteshit kanë qasje më të dobët në institucionet parashkollore dhe shkollat fillore, në krahasim me mesataren e Kosovës kur bëhet fjalë për afërsi gjeografike. Institucioni më i afërt parashkollor mund të arrihet mesatarisht për 27 minuta (në krahasim me mesataren e Kosovës prej 20 minuta).⁶

4. Prezenca e strukturave paralele. Komuna nuk ka arritur t'i eliminojë strukturat paralele të Serbisë që i ofrojnë qytetarëve shërbime administrative dhe teknike në këtë lokalitet. I tërë sistemi shëndetësor dhe ai arsimor në këtë komunë kontrollohet nga ana e strukturave paralele serbe. Këto struktura refuzojnë ta pranojnë dokumentacionin e lëshuar për qytetarë nga ana e institucioneve të Kosovës dhe si rrjedhojë pamundësohet marrja e shërbimeve, veçmas në objektet shëndetësore.⁷ Banorët jo serb të kësaj komune në shumicën e rasteve drejtohen në qendrat mjekësore në Viti dhe Gjilan për shërbime mjekësore.

5. Mungesa e tregut të gjelbër. Parteshi nuk ka të rregulluar treg të posaçëm ku qytetarët do të mund në formë të rregulluar t'i ekspozonin dhe tregtonin mallin e tyre. Kjo shtynë banorët e kësaj ane t'i shfrytëzojnë skajet e rrugëve për shitjen e gjësendeve të ndryshme. Përveç që vlerësohet formë jo e përshtatshme për tregtimin e sendeve, njëherazi konsiderohet edhe si faktor që shkakton rrezik në komunikacion, ngase automjetet që ndalen nga vozitësit me qellim të blerjes së sendeve ekspozohen rrezikut të aksidenteve në komunikacion.

Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur

1. Shtëpia e Kulturës. Parteshi gjatë tri viteve të fundit ka arritur të ndërtojë një shtëpi të kulturës e cila kryen funksione edhe për aktivitete teatrale e rinore. Qytetarët në këtë komunë shprehin se megjithatë kjo shtëpi e kulturës duhet mirëmbajtur dhe promovuar edhe më shumë.

2. Tokat bujqësore. Njëra nga gjërat që duhet ruajtur në Partesh janë edhe tokat e shumta bujqësore. Krahas disa vendbanime

⁶ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. "Mozaiku i Kosovës". 2012. Fq 113. Burimi:http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216825.pdf


⁷ Agjencia e lajmeve "Qendra për Informimin e Kosoves". Burimi: <http://www.kosova.com/artikulli/73389>

tjera në Kosovë edhe Parteshi ka cilësi të mirë të tokave bujqësore që u mundëson banoreve rendimente të mira për shume të mbjella. Këto toka bujqësore përgjithësisht nuk ruhen dhe iu janë ekspozuar ndërtimeve të ndryshme të vrazhda të cilat e pakësojnë dhe e dëmtojnë tokën bujqësore.

Trendët Buxhetore në Komunën e Parteshit

Komuna e Parteshit në vitin 2013 ka 957 mijë euro buxhet apo 40 mijë euro më shumë se në vitin 2010. Në vitin 2012, kjo komunë ka pasur 24 mijë euro të hyra vetanake apo 10 mijë euro më shumë se në vitin paraprak. Në vitin 2012, peshën më të madhe në buxhetin e komunës e zënë pagat dhe mëditjet me 68% e përcjellur nga shpenzimet kapitale me 17%.


Figura 1. Buxheti i Komunës së Parteshit 2013



Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?partesh/2013#/~/~partesh>

Një gjë që bie në pah tek trendet e ndarjeve buxhetore (figura 2) është se investimet kapitale kanë pasur një trend të vazhdueshëm rënës. Nëse krahasojmë peshën e investimeve kapitale në buxhet shohim se në vitin 2011 këto shpenzime përbënin 53% të buxhetit, ndërsa në vitin 2013 ato përbëjnë vetëm 17 % të buxhetit. Sa i përket kontrollit të shpenzimeve, auditori ka gjetur se janë kryer pagesa nga kode të gabuara buxhetore.⁸ Në bazë të raportit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, Komuna e Parteshit rekomandohet që të përmirësojë cilësinë e pasqyrave financiare dhe të regjistrojë pasuritë financiare të komunës.

Figura 2. Trendet e Ndarjeve Buxhetore 2011-2013



Instituti GAP nuk ka mundur të ketë qasje në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2014-2016 të Komunës së Parteshit.

⁸ ZAP, Raporti i Auditimit mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Parteshit për Vitin e Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 06 Gusht 2013, http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPA_2012_Shqip_895291.pdf

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorim të fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulumtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Parteshit është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP janë mbështetur me të dhënat kuantitative të siguruara përmes anketës së zhvilluar nga ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.